

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KUVENDIKOMUNAL - ISTOGUT

Për Aktivitetin e Prokurimit: 633-19-1533-1-2-1633-019-009R-121

Sa i përket tenderit për: FURNIZIMI DHE MONTIMI I SERAVE TUNEL

Kundër Njoftimit mbi Vendimet e Autoritetit Kontraktues të datës: 10.05.2019

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

N.P.T EURO-SERA

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kline

(Adresa)

Kline

(Vendi) (Kodi postar)

049149281

(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Arlinda Sejdi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

eurosera@hotmail.com

(Adresa elektronike)

14.05.2018

(Data e parashtrimit të kërkesës) (Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Aktiviteti i prokurimit është publikuar me datën 28.03.2019 Pranimi/dorëzimi i ofertave me date: 16.04.2019 Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dt: 10.05.2019

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Procedura e hapjes së ofertave është bërë në pajtim me nenin 58 të LPP-së dhe çmimin i ofruar nga N.P.T Euro-Sera ka qenë në pajtim me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.
--

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

Me date:10.05.2019 nga AK-Komuna Istogut përmes e-prokurimit me kemi pranuar letrën standarde të tenderuesit të eliminuar.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues/Komuna Istogut ka bere shkelje te këtyre dispozitave te LPP-se:

- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shitesë

Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te dispozitave te UOPP, si:

- Neni 39 Sqarimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Kërkesa për rishqyrtim brenda afatit Ligjor

Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga N.P.T Euro-Sera kundër vendimit të autoritetit kontraktues të datës: **10.05.20019** është brenda afatit ligjor 5 ditor duke llogaritur ditën e premte **10.05.2019** deri ditën e Marte ne ora 16:00 dt:**14.05.2019**. **Konform UOPP Neni 43 paragrafi 3** Nëse njoftimi publikohet në ditën e premte, afati kohor për parashtrim të ankesës fillon ditën e premte sepse:

- ✓ **Dita e premte është ditë pune**
- ✓ Në përputhje me Nenin 4, paragrafi 4.2 të Rregullave për parashtrim të ankesave, data e njoftimit është **“dita 0” e 5 ditëve.**

Kërkesa për rishqyrtim kundër vendimit të AK-ISTOGUT të dt 10.05.2019 është në pajtim me Nenin 108/A paragrafi 3 pika 2 të LPP-se.

NJE Pretendim Ankimor

Kërkesa për rishqyrtim paraqitet vetëm për “**NJE**” pretendim ankimor pasi që është edhe një arsye e eliminimi të ofertës sipas letrës standarde të tenderuesit të eliminuar dt. 10.05.2019.

Vendimi i Autoritetit kontraktues të datës: 10.05.2019

AK-Komuna e ISTOGUT ka ngrit në sistem e-prokurimit njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku në përmbajtjen e këtij vendimi ceket se AK ka shpërblyer me kontrate të përkohshme OE N.T.P. **Adri Zaun – Rrethoja.**
Dëshmi: Njoftimi i dt: **10.05.2019** nga e-prokurimi.

Letra standarde të Tenderuesit të eliminuar të datës: 10.05.2019

Nga platforma e-prokurimit me datën: **10.05.2019** kemi pranuar letrën standarde të tenderuesit të eliminuar ku është cek se nuk kemi plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit respektivisht **“DESHMIJA MUNGON NOTERIZIMI I DIPLOMËS SË INXH.ËSHTË E NOTERIZUAR PARA NJOFTIMIT PËR KONTRATË A NË KËRKESË ËSHTË PAS NJOFTIMIT PËR KONTRATË”.**

Kërkesa për qasje në Oferta të datës 13.05.2019

Në pajtim me Nenin 10 paragrafi 3 dhe 5 të LPP-se me dt: **13.05.2019** kemi kërkuar qasje në të gjitha ofertat për këtë aktivitet të prokurimit dhe po me të njëjtën datë zyra e prokurimit na ka lejuar qasje në të gjitha ofertat, andaj përmes USB kemi bërë tërheqjen e të gjitha ofertat përfshirë edhe ofertën e OE të rekomanduar për dhënie të kontratës/përkohshme **Adri Zaun-rrethoja.**

MOSPAJTIM ME KOMSIONIN VLERESUES DHE ZYREN E PROKURIMIT

N.P.T Euro-Sera nuk pajtohet me vlerësimin e ofertës si te papërgjegjshme sipas letrës standarde te tenderuesit te eliminuar pasi qe kopja e diplomës se noterizuar para njoftimit për kontrate nuk paraqet asnjë shkelje te dispozitave te Nenit 59 te LPP-se. Komisionit vlerësues ja lejon Nenin 59 paragrafi 4 pika *(i dhe ii)* qe një tender te konsiderohet i përgjegjshëm për shkak te devijime te vogla qe nuk janë substacionale siç janë ne këtë rast. Ne këto dispozita *(i dhe ii)* ceket si vijon: ***Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.***

Komisioni i vlerësimit ne pajtim me Nenin 59 paragrafi 2 , Nenin 72 te LPP-se dhe UOPP Neni 39 ka pasur hapësirë ligjore te mjaftueshme te kërkoj sqarime shtese apo informata shtese tek OE N.P.T EURO SERA, pra pasi qe diploma e noterizuar ***(Para njoftimit për kontrate)*** është pjese e ofertës te kërkoj dëshmi shtese a mund te sjellim përsëri diplomën e noterizuar pas njoftimit për kontrate. Këtë çështje e rregullon mjaft qarte UOPP Neni 39 paragrafi: 3, 4 dhe 5:

Paragrafi 3: *Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, te cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit te Njoftimit për kontrate.*

Paragrafi 4: *Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit te informacionit shtese në kushte të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë dhe do të kërkojë informacion nga operatorët ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, certifikatave te përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit.*

Paragrafi 5: *Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE.*

OE N.T.P. Adri Zaun – Rrethoja- Kopjen e diplomës se noterizuar PARA NJOFTIMIT PËR KONTRATE

Pas qasjes ne oferta dhe kontrollimit te dokumentacionit te OE te rekomanduar për dhënie te kontratës NTP **Adri Zaun-Rrethoja**, kemi konstatuar se diploma e noterizuar **Adnan Milaim Kelmendi është noterizuar me date: 13.03.2018 nga noterja Ma.Sc. Arbena Shehu.** Pra diploma e noterizuar është para njoftimit për kontrate dhe disa muaj me e vjetër se diploma e noterizuar e Inxhinerit Kadri Zeqir Berisha te NPT EURO SERA, pra diploma e tij është e noterizuar me dt:30.05.2018 nga noteri Bedri Godanci.

Duke ju referuar diplomës se noterizuar para njoftimit për kontrate te OE NTP Adri Zaun-Rrethoja, komisioni i vlerësimit nuk ka vepruar ne pajtim me Nenin 59 te LPP-se për te cilin ka pas obligim ligjor te vlerësoj dhe ekzaminoj ofertat ne pajtim me dosjen e tenderit.

Komisioni vlerësimit përveq mos respektimit të këtij Neni ka bërë shkelje të Neni 7 të LPP-se pasi që ofertën e OE Adri Zaun-rrethoja ka vlerësuar të përgjegjshme për një dokument i cili ka qenë para njoftimit për kontratë, ndërsa dokumentin tjetër të njëjtë e ka kualifikuar të papërgjegjshëm që nuk i plotëson kërkesën dosje të tenderit. Përfundimisht komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave ka bërë mostrajtim të barabartë dhe diskriminim të ofertës së OE NPT EURO SERA për këtë procedurë prokurimi duke ju referuar se kemi ofruar çmim me të lirë në raport me OE e rekomanduar për dhënienë të kontratës.

Paragrafi 1: Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Paragrafi 2: Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatoreve ekonomik.

Dëshmitë bashkangjitura:

1.OE N.T.P. Adri Zaun – Rrethoja./ Kopje e diplomës së noterizuar PARA njoftimit për kontratë (Adnan Milaim Kelmendi është noterizuar me datë: 13.03.2018 nga noterja Ma.Sc. Arbena Shehu).

2.OE N.P.T EURO SERA/ Kopje e diplomës së noterizuar para njoftimit për kontratë (Kadri Zeqir Berisha është e noterizuar me dt:30.05.2018 nga noteri Bedri Godanci).

Përfundimisht komisioni i vlerësimit:

- Nuk ka respektuar Nenin 6 ekonomikitetin dhe efikasitetin, pasi që me veprimet e tyre ka vënë në rrezik dëmtimin e parasë publike ku përmes këtij neni të gjithë zyrtarët obligohen që veprimet e tyre të jenë në pajtim ekonomikitetin për çdo procedurë prokurimi.
- Për shkak të veprimeve të tyre të njëanshme nuk është respektuar Neni 60 pasi që në DT është kërkuar Tenderi i përgjegjshëm me çmimin me të lirë, ku këtë kriter ligjor NPT EURO SERA e plotëson duke ju referuar procesverbalit të hapjes së ofertave.

NPT EURO SERA kërkojmë nga ZPP/Zyrtari Përgjegjës i prokurimit të anulohet njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt: 10.05.2019 pasi që vendimi në fjalë nuk është në përputhje me kërkesat DT dhe njoftimit për kontratë. Po ashtu kërkojmë nga ZPP në përputhje me Nenin 59 dhe 72 të LPP-se nëse është e nevojshme të kërkonin sqarime shtesë apo informata shtesë tek OE NPT EURO SERA për diplomën e noterizuar para njoftimit për kontratë apo mund të vepronin në pajtim me Nenin 59 paragrafi 4 (i dhe ii) të LPP-se/devijim i vogël që oferta të kualifikohet e përgjegjshme.

PROPOZIM

Konform Rregullores për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese kërkojmë të **APROVOHET si e BAZUAR kërkesa për Rishqyrtim kundër njoftimit të vendimit të autoritetit kontraktues të datës: 10.05.2019 dhe pas procesit të Rivlerësimit oferta N.P.T Euro-Sera të shpallet e përgjegjshme në pajtim me dispozitat e LPP-se (Letër standarde tenderuesit të suksesshëm).**

Oferta i ka plotësuar në tërësi të gjitha kërkesat DT dhe kemi ofruar tenderin e përgjegjshëm me çmimin me të lirë

N.P.T Euro-Sera pret përgjigje nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit në afat 3 ditësh në pajtim me Nenin 6 paragrafi 3 të Rregullores për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim të ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave të ankesave. Mos kthimi i përgjigjes brenda afateve ligjore në pajtim me Rregulloren në fjalë dhe Nenin 109 të LPP-se do të drejtohet OSHP-se me Ankesë për këtë procedurë prokurimi.

Me respekt

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Dëmtim i imazhit të operatorit ekonomik N.P.T Euro-Sera ne treg.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*